



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GJIROKASTËR  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR 53, DATË 05.07.2022

**“MBI SISTEMIMIN E 5% SË GARANCISË SË PUNIMEVE, PËR TË CILAT KA KALUAR AFATI I MARRJES NË DORËZIM SË ÇERTIFIKATËS SË PËRHERSHME TË OBJEKTIT DHE KALIMIN NË TË ARDHURAT E BASHKISË ME QËLLIM PËRDORIMIN E TYRE NË INTERES PUBLIK”**

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës 05.07.2022 pasi shqyrto materialin e paraqitur “Mbi sistemimin e 5% së garancisë së punimeve, për të cilat ka kaluar afati i marrjes në dorëzime të certifikatës së përhershme të objektit dhe kalimin në të ardhurat e Bashkisë me qëllim përdorimin e tyre në interes publik”. Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr 7850, datë 29.12.1994 “Për Kodin Civil të RSH” i ndryshuar, ligjin nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore, Udhëzimin nr 3, datë 13.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Udhëzimin plotësues nr 01, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, VKB nr.107, datë 24.12.2021 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2022”, VKB nr 108, datë 24.12.2021 “Për miratimin e PBA 2022-2024”

**VENDOSI:**

1. Mbi bazën e pasqyrave financiare të Bashkisë të realizohen të gjitha procedurat dypalëshe midis Degës së Thesarit dhe Bashkisë Gjirokastër për shbllokimin e fonde të krijuara nga garancitë e punimeve publike 2012-2016 dhe kalimin e tyre në të ardhurat e Bashkisë.
2. Të miratojë fillimin e procedurave ligjore për zbatimin e projekt idesë me objekt “Rehabilitimi urban i hapësirave publike në tregun ekzistues të fruta perimeve dhe të godinës së projektuar për treg të brendshëm” sipas formatit bashkëngjitur.
3. Fondet e përfituara pas rakordimit përfundimtar të ekzekutivit me Degën e Thesarit të përdoren për financimin e projektit “Rehabilitimi urban i hapësirave publike në tregun ekzistues të fruta perimeve dhe të godinës së projektuar për treg të brendshëm” pas përfundimit të procedurave për zbatimin e projektit.
4. Ndryshimi buxhetor në buxhetin e bashkisë për vitin 2022 të jetë si më poshtë:

Shtesë

Gr.00. Tit.04130 Kap. Art 231 kod projekti në shumën 11 810 318 lekë

5. Përcaktimi i burimit të financimit për kapitullin, të bëhet pas rakordimit përfundimtar me Degën e Thesarit.

6. Për implementimin e projektit “Rehabilitimi urban i hapësirave publike në tregun ekzistues të fruta perimeve dhe të godinës së projektuar për treg të brendshëm”, të bëhen ndryshime në vendimin nr 108, datë 24.12.2021, për financim në buxhet 2023 në shumën 39 645 827 lekë.

7. Pas përfundimit të procedurave për pikën 1 dhe 2 të realizohen rishikimet sipas rastit.

8. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi.

9. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit

Etleva Yzo

KRYETARI I KËSHILLIT

Lavdi Hasani